



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji nr.2004/50

PËR VEPRIMTARINË PRIVATE NË SHËNDETËSI

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë Rregullorja Nr. 2001/9 të datës 15.maj 2001, në pajtim me Kreun 5.1 (ë), 9.1.1, 9.1.26 (a) dhe ,
me qëllim të vënies së bazës ligjore për rregullimin, përparimin dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve të Kosovës, nëpërmjet rregullimit të veprimtarisë private në shëndetësi,

Miraton:

LIGJIN PËR VEPRIMTARINË PRIVATE NË SHËNDETËSI

Kreu I

Përkufizimet

Neni 1

“**Veprimtaria e kujdesit shëndetësor**” nënkupton të gjitha veprimet që kanë për qëllim: përparimin dhe përmirësimin e shëndetit, parandalimin e sëmundjeve dhe të lëndimeve, diagnostikimin, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin shëndetësor të qytetarëve;

“**Institucioni privat i kujdesit shëndetësor**”(në tekstin e mëtejme, Institucioni): çdo vend, objekt në pronësi private, që përmbush kushtet dhe standardet për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, të përcaktuara me këtë Ligj, dhe me akte të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë.

“**Bordi për Licencim të institucioneve të kujdesit shëndetësor privat**” (në tekstin e mëtejme Bordi): organ i autorizuar i Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës (në tekstin e mëtejme, Ministria), për licencim të Institucionit, i themeluar me këtë Ligj;

“**Licenca për ushtrimin e veprimtarisë private shëndetësore**” (në tekstin e mëtejme Licenca): autorizimi me shkrim për lejimin e ushtrimit të **veprimtarisë** private shëndetësore, i lëshuar nga Bordi;

“**Punëtori shëndetësor nga neni 86 i Ligjit për Shëndetësi**”: profesionisti i kujdesit shëndetësor, i cili posedon licencën e lëshuar nga Bordi Qendror për Regjistrim dhe Licencim, pranë Ministrisë;

“**Punonjësi privat i kujdesit shëndetësor**”: Profesionisti i licencuar i kujdesit shëndetësor që ushtron veprimtari private në Institucionin privat të kujdesit shëndetësor apo në institucionin publik të kujdesit shëndetësor në bazë të kontratës me institucionin përkatës”

“**Themelues i Institucionit të kujdesit shëndetësor**”: personi fizik apo juridik, vendas apo i huaj i cili themelon institucionin privat të kujdesit shëndetësor në bazë të dispozitave ligjore në fuqi;

“**Drejtori i Institucionit**”: personi i emëruar, i cili udhëheq dhe përfaqëson Institucionin;

“**Standardet e kujdesit shëndetësor**”: standardet e kujdesit shëndetësor, të përcaktuara me akt nënligjor, të nxjerrë nga Ministria.

Kreu II

Profesionistët e kujdesit shëndetësor në sektorin privat Neni 2

2.1. Profesionisti i kujdesit shëndetësor, mund të ushtrojë veprimtarinë shëndetësore në sektorin privat të Kosovës, nëse:

- a). është profesionist i licencuar i shëndetësisë;
- b). nuk është ndaluar me vendim juridik të një gjykate ose organi tjetër kompetent për të ushtruar veprimtarinë e shëndetësisë;
- c). i plotëson kushtet për përvojën e nevojshme të punës në fushën përkatëse, sipas akteve nënligjore të nxjerra nga Ministria.

2.2. Profesionisti i kujdesit shëndetësor ushtron veprimtarinë private shëndetësore në pajtim me Ligjin për Shëndetësi të Kosovës, këtë Ligj dhe ligjet e tjera përkatëse.

2.3. Profesionisti i kujdesit shëndetësor mund të ofrojë shërbime private të kujdesit shëndetësor në institucione publike shëndetësore, në bazë të kontratës me Institucionin përkatës.

2.4. Punonjësi privat shëndetësor u nënshtrohet kushteve të njëjta të regjistrimit, licencimit dhe edukimit të vazhdueshëm profesional si edhe punonjësi shëndetësor në institucionet publike të kujdesit shëndetësor.

2.5. Punonjësi privat shëndetësor duhet të përdorë vulën zyrtare të profesionistit shëndetësor, konform akteve nënligjore.

2.6. Punonjësi privat shëndetësor mund të ofrojë shërbime shëndetësore konform përgatitjes së tij profesionale.

Të drejtat dhe detyrimet e punonjësve privatë të kujdesit shëndetësor
Neni 3

3.1 Punonjësit privat të kujdesit shëndetësor i takojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara me Ligjin e Punës.

3.2 Punonjësi privat i kujdesit shëndetësor ka detyrë të kryejë si më poshtë :

- a). Të ofroj shërbime të kujdesit emergjent shëndetësor;
- b). Të ofroj shërbime të kujdesit shëndetësor në pajtim me doktrinën e pranuar mjekësore si dhe parimet e etikës mjekësore;
- c). T'u përmbahet standardeve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor;
- d). Të marrë pjesë në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në rastet e gjendjeve të jashtëzakonshme, me ftesë të organeve kompetente;
- e). Të marrë pjesë në programet për eliminimin e sëmundjeve ngjitëse, me ftesë të organeve kompetente;
- f). Ti respektoj të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor, në pajtim me ligjin sipas paragrafit 5.1 (c).

Kreu III

Themelimi i Institucionit

Neni 4

4.1. Veprimtaria shëndetësore private zbatohet në Institucionet e themeluara në pajtim me Ligjin për Shëndetësi të Kosovës, këtë Ligj dhe Ligjet tjera përkatëse.

4.2. Institucioni licençohet për të ofruar shërbime të kujdesit shëndetësor, nëse i plotëson kushtet e përcaktuara sipas Ligjit për Shëndetësi të Kosovës, këtë Ligj dhe aktet tjera nënligjore.

4.3. Institucionet Private të kujdesit shëndetësor nuk do të ushtrojnë veprimtari shëndetësore nëse nuk kanë Licencën e lëshuar nga Bordi.

4.4. Bordi kryen Licencimin e Institucioneve.

4.5. Llojet e Institucioneve i përcakton Ministria me akt nënligjor.

4.6. Plani i rrjetit të Institucioneve miratohet nga Ministria, duke respektuar parimet e njëjta që vlejnë për institucionet publike të kujdesit shëndetësor.

4.7. Plani i rrjetit sipas paragrafit të mëparshëm përbëhet nga numri dhe kapaciteti i Institucioneve, të harmonizuara me standarde dhe emërtime.

4.8. Kushtet e përgjithshme minimale të Institucioneve lidhur me hapësirën, personelin dhe pajisjen mjekësore i përcakton Ministria me akt nënligjor.

4.9. Institucionet sipas paragrafit 4.6 kanë detyrim të hyjnë në marrëveshje kontraktuale me Agjencinë Komisionere të Kujdesit Shëndetësor ose, pas formimit të tij me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, për të ofruar shërbime të kujdesit shëndetësor.

Detyrimet e Institucionit
Neni 5

5.1. Institucioni ka detyrë:

- a). t'u përmbahet detyrimeve ligjore lidhur me shërbimet shëndetësore që vlejné për institucionet publike shëndetësore;
- b). të nxjerrë statutin dhe rregulloret operative të Institucionit;
- c). të sigurojë përgjegjësinë civile për dëmet e shkaktuara ndaj shëndetit të qytetarëve gjatë shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore në Institucion, në pajtim me Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor;
- d). të zgjedhë dhe të emërojë Drejtorin e Institucionit;
- e). të përfshihet në Sistemin unik të Informimit Shëndetësor;
- f). të ruajë dokumentacionin dhe regjistrat mjekësorë në gjendje të mirë, për periudhën kohore të përcaktuar me ligj;
- g). të ruajë dokumentacionin shëndetësor nëse Institucioni pushon së funksionuari veprimtarinë e tij, në pajtim me ligjin;
- h). t'u përmbahet standardeve për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, të miratuara nga Ministrria;
- i). t'u sigurojë mundësi qasjeje personave me aftësi të kufizuara;
- j). të sigurojë menaxhimin e përshtatshëm të mbeturinave sipas standardeve të pranuar;
- k). të paraqesë listën e shërbimeve që ofron;
- l). të sigurojë kuadër profesional për ofrimin e shërbimeve nga lista e paraqitur e shërbimeve të ofruara;
- m). t'i përmbahet çmimoreve të harmonizuara të shërbimeve shëndetësore;
- n). të sigurojë numrin e duhur të të punësuarve me kualifikime përkatëse, në pajtim me licencën e punës së Institucionit;
- o). të raportojë mbi aktivitetet e veta në institucionet e përcaktuara me ligj;
- p). t'u sigurojë vazhdimësinë e kujdesit shëndetësor qytetarëve, në rast se për çfarëdo arsyeje nuk mund të sigurojë shërbimet e caktuara të kujdesit shëndetësor;
- q). të sigurojë referimin e qytetarëve në bazë të ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore;
- r). t'i respektojë të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve nën kujdesin shëndetësor, në pajtim me ligjin sipas paragrafit 5.1 (c);
- s). të sigurojë zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me metodat dhe procedurat për kontrollin, ruajtjen, shpërndarjen dhe administrimin e barnave, nëse Institucioni ofron barna për qytetarët;

- t). të vendosë një tabelë me emrin dhe llojin e Institucionit si dhe orarin e punës në ndërtesën ku vepron Institucioni privat i kujdesit shëndetsor;
- u). të vendosë, në vend të dukshëm, orarin e punës, çmimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe informata mbi realizimin e të drejtave të qytetarëve nën kujdesin shëndetësor, në pajtim me ligjin sipas paragrafit 5.1(c);
- v). të informojë Ministrinë për ndryshimin e veprimtarisë;
- w). të informojë Ministrinë për ndërprerjen e aktiviteteve të veta, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para ndërprerjes;
- x). t'i përmbushë kushtet shtesë, të përcaktuara nga Ministria me akte të veçanta nënligjore;

5.2. Veprimtaria private shëndetësore nuk lejohet në fushat e përcaktuara me nenin 45 të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës.

Kreu IV

Standardet e domosdoshme

Neni 6

6.1. Institucionet dhe punëtorët shëndetësorë duhet t'u përmbahen standardeve të domosdoshme për kujdesin shëndetësor, të përcaktuara me akte nënligjore, të nxjerra nga Ministria, në fushat e mëposhtme:

- a). informatat për qytetarët;
- b). cilësia e shërbimeve të kujdesit shëndetësor;
- c). menaxhimi dhe personeli;
- d). menaxhimi i ankesave të qytetarëve;
- e). ndërtesat, objektet dhe pajisjet;
- f). procedurat për menaxhimin e rrezikut;
- g). regjistrat dhe informimi.

6.2. Standardet sipas paragrafi më sipër duhet të jenë në pajtim me standardet e pranuar ndërkombëtare.

Standardet shtesë

Neni 7

7.1. Ministria mund të përcaktojë standardet shtesë që duhen plotësuar nga Institucioni, në varësi të llojit dhe veprimtarisë së tij.

7.2. Ministria mundet në çdo kohë të revokojë, të ndryshojë apo të plotësojë ndonjë standard për kujdesin shëndetësor.

Kreu V

Roli i Ministrisë

Neni 8

Ministria me qëllim të zbatimit të Ligjit për Shëndetësi, dhe këtij Ligji duhet të kryejë si më poshtë:

- a). Të kujdeset për shëndetin e qytetarëve që shfrytëzojnë shërbimet shëndetësore në sektorin privat të shëndetësisë në Kosovë;
- b). Të hartojë politikën dhe strategjinë zhvillimore të sektorit privat në shëndetësi;
- c). Të hartojë normat dhe standardet e nevojshme dhe ato plotësuese lidhur me hapësirën, pajisjet dhe personelin e institucioneve;
- d). Të bashkëpunojë me Këshillin e Përgjithshëm Profesional në përpilimin e listës unike të çmimeve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor në Institucione;
- e). Të bashkëpunojë me Ministrinë, Komunat dhe institucionet e tjera, të cilat në mënyra të ndryshme janë të përfshira në zhvillimin e sektorit privat në shëndetësi;
- f). Të ushtrojë mbikqyrjen e jashtme administrative mbi institucionet;
- g). Të mbikëqyrë veprimtarinë e Bordit të licencimit;
- h). Të nxjerrë rregulloren operative dhe dokumentacionin përkatës mbi mënyrën dhe punën e Komisioneve;
- i). Të mbikëqyrë rolin e Komunave në zbatimin e legjislacionit në lidhje me me sektorin privat në shëndetësi.

Kreu VI

Bordi për licencim të institucioneve të kujdesit privat shëndetësor

Neni 9

9.1. Bordi është organ i autorizuar nga Ministria me këtë Ligj.

9.2. Organi sipas paragrafit të mëparshëm ka të gjitha të drejtat dhe kompetencat e përcaktuara me Ligjin për Shëndetësi të Kosovës dhe këtë Ligj.

Funksioni dhe detyrat e Bordit

Neni 10

Funksionet e Bordit janë si më poshtë:

- a). Të zbatojë politikat e Ministrisë lidhur me sektorin privat të shëndetësisë;
- b). Të sigurojë zbatimin e standardeve të nevojshme të kërkuara për Institucionet dhe verifikimin e këtyre standardeve me kërkesë të themeluesit;
- c). Të kryejë licencimin e institucioneve;
- d). Të revokojë Licencat;

- e). Të mbajë regjistrin e Institucioneve dhe punonjësve privatë shëndetësorë;
- f). Të kryejë funksione të tjera që i jepen Bordit nga ana e Ministrisë.

Neni 11

11.1. Bordi duhet të nxjerrë rregulloren operative, ku përfshihet plani dhe mënyra e punës së tij.

11.2. Ministria duhet t'i shpallë Vendimet e bordit në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

Përbërja e Bordit Neni 12

12.1. Bordi përbëhet nga pesë (5) anëtarë, përfaqësues të institucioneve dhe të sektorëve, si vijon:

- a). Zyrtari nga divizioni i praksës private;
- b). Sektori privat;
- c). Këshilli i Përgjithshëm Profesional;
- d). Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor;
- e). Asociacioni i Komunave të Kosovës;

12.2. Bordi ka pavarësi të plotë në marrjen e vendimeve.

Udhëheqja e Bordit Neni 13

13.1. Bordi drejtohet nga Kryetari, të cilin e emëron Ministri i Shëndetësisë me propozim të Bordit.

13.2. Ministria duhet të sigurojë Sekretarinë teknike të Bordit.

Mandati i anëtarëve të Bordit Neni 14

14.1. Anëtarët e Bordit emërohen për afat kohor tre (3) vjeçar.

14.2. Anëtarët kanë të drejtë riemërimi vetëm për një afat kohor të dytë tre (3) vjeçar.

14.3. Në rast të konfliktit të interesit anëtari i Bordit nuk merr pjesë në vendimmarrje.

Përfundimi i mandatit të anëtarëve të Bordit Neni 15

Mandati i anëtarit të Bordit përfundon në situatat, si vijon:

- a). pas skadimit të afatit të mandatit;
- b). kur anëtari jep dorëheqje me shkrim;
- c). kur anëtari largohet nga detyra me vendim të Gjykatës;
- d). kur anëtari nuk është në gjendje të kryejë detyrat e tij për shkaqe të tjera serioze personale;

Procedurat për shkarkimin e anëtarit të Bordit
Neni 16

Në rast të shkeljes serioze të detyrave të punës, procedura për shkarkimin e anëtarit të Bordit fillohet nga Institucioni që e ka propozuar atë ose Ministria e Shëndetësisë.

Financimi i Bordit
Neni 17

17.1. Bordi financohet nga të hyrat e veta në bazë të aktit nënligjor, të nxjerrë nga Ministria dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe nga burimet shtesë të Ministrisë.

17.2. Kompensimi material i anëtarëve të Bordit bëhet sipas akteve përkatëse nënligjore, të nxjerra nga Ministria.

Kreu VII

Komisionet për vlerësimin e përmbushjes së kushteve teknike dhe profesionale për
licencim të Institucioneve Private të kujdesit Shëndetësor
Neni 18

18.1. Ministria, me një akt të veçantë, formon Komisionet e përbashkëta në bashkëpunim me autoritetet komunale shëndetësore dhe Shoqatën e Mjekëve Privatë të Kosovës. Detyra e Komisionit është që të bëjë inspektimin e Institucionit me qëllim të vlerësimit të përmbushjes së kushteve teknike dhe profesionale për licencim.

18.2. Komisionet përbëhen nga pesë (5) anëtarë:

- a). Inspektori sanitar Komunal në Komunën ku gjendet institucioni;
- b). Inspektori Komunal i punës në Komunën ku gjendet institucioni;
- c). Inspektori Komunal për Ndërtime në Komunën ku gjendet institucioni;
- d). Sektori privat nga fusha që i përket Institucioni;
- e). Autoriteti Shëndetësor i Ministrisë, që mbulon Komunën ku gjendet Institucioni.

18.3. Komisioni bën vlerësimin e kushteve në bazë të normave dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria sipas Ligjit të Shëndetësisë, këtij Ligji, akteve nënligjore dhe legjislacionit përkatës.

18.4. Komisioni bën inspektimin me kërkesë të Institucionit, jo më vonë se tridhjet (30) ditë pas paraqitjes së kërkesës.

18.5. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për Institucionet do t'i caktojë Ministria me një akt të veçantë nënligjor.

18.6. Anëtarët e Komisionit kompensohen sipas akteve përkatëse nënligjore.

Licencimi Neni 19

19.1. Themeluesi i Institucionit të nivelit dytësor dhe i nivelit tretësor të kujdesit shëndetësor, duhet që fillimisht të sigurojë pëlqimin për themelimin e Institucionit nga Ministria, ndërsa themeluesi i Institucionit në nivelin e kujdesit parësor shëndetësor duhet ta sigurojë këtë pëlqim nga Komuna.

19.2. Institucioni mund të ofrojë shërbime shëndetësore, nëse i plotëson kushtet e përcaktuara në Ligjin për Shëndetësinë e Kosovës, këtë Ligj, ligjet përkatëse dhe aktet e tjera nënligjore.

19.3. Institucioni nuk mund të licencohet në rast se nuk e ka përmbushur detyrimin sipas paragrafit 5.1 (c) të këtij Ligji.

19.4. Licenca e lëshuar nga Bordi është kusht i domosdoshëm që Institucioni të marrë lejen e punës.

Aplikimi për licencë Neni 20

20.1. Aplikimi për licencë bëhet në Ministrinë e Shëndetësisë me formular të veçantë duke bërë pagesën administrative, vlerën e së cilës e përcakton Ministria .

20.2. Liçenca duhet të përmbajë kushtet të cilat kërkohen të përmbushen dhe lëshohet në formular të aprovuar nga Ministria.

20.3. Aplikimi për Licencë bëhet edhe në rast të ndryshimit/zgjerimit të veprimtarisë.

20.4. Bordi mund të kërkojë edhe përmbushjen e kushteve shtesë, sipas standardeve dhe normave të përcaktuara nga Ministria.

20.5. Ministria përcakton afatin kohor për përmbushjen e kushteve shtesë;

Vendimi për licencë Neni 21

21.1. Lidhur me aplikimin për licencim të Institucionit, Bordi mund të vendosë për:

- a). lejimin e licencës;
- b). refuzimin e dhënies së licencës.

21.2. Kundër vendimeve të Bordit, aplikuesi mund të paraqesë ankesë në Ministri. Ministria duhet t'i përgjigjet me shkrim aplikuesit brenda një afati jo më të gjatë se tridhjetë (30) ditë.

21.3. Kundër vendimit të Ministrisë, aplikuesi mund të ushtrojë ankesë në gjykatën kompetente, në pajtim me ligjet përkatëse.

Vlefshmëria e licencës Neni 22

- 22.1. Licenca është e vlefshme për periudhën pesë (5) vjeçare dhe hyn në fuqi në datën e lëshimit.
- 22.2. Bordi duhet të informojë aplikuesin lidhur me vendimin e marrë brenda afatit të përcaktuar.

Përtëritja e licencës Neni 23

- 23.1. Çdo licencë duhet të përtëritet në pajtim me këtë Ligj.
- 23.2. Përtëritja e licencës bëhet me anë të aplikimit, në formë të shkruar, drejtuar Bordit.
- 23.3. Aplikimi për përtëritje të licencës bëhet jo më herët se 120 ditë dhe jo më vonë se 60 ditë para skadimit të saj.
- 23.4. Bordi mund të përtërijë licencën për të cilën është bërë aplikacioni për periudhën që nuk kalon pesë (5) vjet.
- 23.5. Pas aplikimit për përtëritje, licenca vazhdon të jetë e vlefshme derisa Bordi të vendosë mbi aplikimin.
- 23.6. Çdo përtëritje në raste të tilla do të ketë efekt nga data e skadimit të licencës.
- 23.7. Bordi nuk do të përtërijë licencën, në rast se aplikuesi nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara me këtë Ligj dhe me ligjet e tjera përkatëse.
- 23.8. Licenca nuk mund të jetë objekt i transferimit nga njëri themelues në themeluesin tjetër.

Revokimi i licencës Neni 24

- 24.1. Bordi është i vetmi organ i cili mund të revokojë Licencën.
- 24.2. Bordi mund të revokojë licencën kur konstaton se poseduesi i licencës nuk ka përmbushur apo nuk i është përmbajtur kushteve të përcaktuara në bazë të këtij Ligji apo ligjeve të tjera përkatëse, apo ndonjë kushti shtesë brenda afatit të përcaktuar ligjor.
- 24.3. Ministri i Shëndetësisë nëpërmes Bordit mund të inicojë procedurën për revokim të licencës në rast shkeljes së kushteve të parapara me këtë Ligj.
- 24.4. Vendimi i Bordit për të revokuar licencën duhet t'i dërgohet poseduesit të licencës.
- 24.5. Forma dhe përmbajtja e Vendimit përcaktohet nga Bordi.
- 24.6. Vendimi për revokim të licencës duhet të publikohet në numrin vijues të Gazetës Zyrtare të Kosovës.
- 24.7. Poseduesi i licencës ka të drejtë ankese kundër vendimit të Bordit para gjykatës, brenda afatit të përcaktuar ligjor.

24.8.Revokimi i Licencës nënkupton automatikisht aplikimin e sërishëm për rilicencimin e Institucionit.

Kreu VIII

Mbikëqyrja e Institucioneve

Neni 25

25.1. Mbikëqyrja e Institucioneve bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shëndetësi të Kosovës, ligjeve përkatëse dhe këtij Ligji.

25.2. Mbikëqyrja e Institucioneve përfshin mbikëqyrjen e brendshme dhe të jashtme.

25.3. Mbikëqyrjen e brendshme profesionale, e organizon dhe e siguron Drejtori i Institucionit, duke u bazuar në rregullat operative të Institucionit.

25.4. Objekt i mbikëqyrjes së Institucionit janë:

- a). aplikimi dhe zbatimi i ligjit dhe akteve nënligjore në veprimtarinë shëndetësore;
- b). mbikëqyrja e punës profesionale të punonjësve shëndetësorë.

Neni 26

26.1. Mbikëqyrja e jashtme profesionale dhe administrative e Institucioneve bëhet nga: Inspektorati Shëndetësor, Bordi, Autoritetet Shëndetësore të Ministrisë përgjegjëse për Komunën përkatëse, Drejtoritë komunale të shëndetësisë si dhe Inspektorati Sanitar i Kosovës.

26.2. Detyrat dhe përgjegjësitë e organeve mbikëqyrëse, si dhe mënyra e mbikëqyrjes, përcaktohen me ligjet përkatëse si dhe akte të veqanta nënligjore, të nxjerra nga Ministria.

26.3. Mbikëqyrja e jashtme bëhet në bazë të planit të punës së organit mbikëqyrës.

26.4. Për mbikëqyrjen e ndonjë aspekti të veçantë të Institucionit, Ministria, mund të emërojë profesionistë të dalluar shëndetësorë, kur e sheh të arsyeshme.

26.5. Gjatë mbikëqyrjes së Institucionit zyrtari mbikëqyrës duhet të identifikohet me kartelën e identifikimit.

Neni 27

27.1. Institucioni dhe punonjësit e shëndetësisë ku zbatohet mbikëqyrja profesionale janë të detyruar të bashkëpunojnë me zyrtarin që bën mbikëqyrjen dhe t'i vënë në dispozicion tërë dokumentacionin e kërkuar.

27.2. Gjatë mbikëqyrjes, zyrtarit mbikëqyrës duhet t'i lejohet qasje e lirë në të gjitha hapësirat e Institucionit.

Dispozitat disiplinore dhe ndëshkimore
Neni 28

28.1. Ndaj Institucionit dhe punëtorëve privatë të shëndetësisë zbatohen dispozitat disiplinore dhe ndëshkimore, të përcaktuara me Ligjin për Shëndetësi të Kosovës si dhe Ligjet e tjera përkatëse.

28.2. Në rast se gjatë mbikëqyrjes së Institucionit konstatohet se me shkeljen e rregullave është kryer kundërvajtje, delikt ekonomik ose vepër penale, zyrtari mbikëqyrës është i detyruar që menjëherë të parashtojë kërkesën për fillimin e procedurës, përkatësisht fletëparaqitjen para organit kompetent.

28.3. Organi, të cilit i është drejtuar fletëparaqitja nga paragrafi i mëparshëm, është i detyruar të informojë Ministrinë për rezultatin e procedurës.

Kreu IX

Dispozitat kalimtare
Neni 29

29.1. Institucionet, personat e tjerë juridikë dhe fizikë, të cilët, në pajtim me këtë Ligj, ushtrojnë veprimtari private shëndetësore, duhet të harmonizojnë organizimin, punën dhe aktet e përgjithshme me dispozitat e këtij Ligji brenda afatit prej 6 muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi.

29.2. Për qëllimet e zbatimit të këtij Ligji, Ministria duhet të nxjerrë aktet përkatëse nënligjore.

Neni 30

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Ligji Nr.2004/50
27 shtator 2004

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

akademik Nexhat Daci